



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:266807
Datë: 31.01.2025
Numri i dokumentit: 06787769

ARJ.nr.149/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË- kolegji në përbërje nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Beshir Islami dhe Zenel Leku, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, Xh.S., nga V., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Vehbi Halili, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, kundër Vendimeve të Zyrave të Gjendjes Civile, me bazë juridike anulim i aktit administrativ - vendimit të të paditurës, nr.75/2021 të datës 15.11.2021, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditëses, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.694/2023, të datës 08.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 30 Janar 2025, merr:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pabazuar, kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësja Xh.S., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit- Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.694/2023, të datës 08.07.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.694/2023, të datës 08.07.2024, Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses, Xh.S., nga V., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2812/21, i datës 11.07.2023, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, paditësja, përmes të autorizuarit të saj, në afat ligjor në Gjykatë Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim të: APROVOHET

si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.694/2023, të datës 08.07.2024 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2812/21, i datës 11.07.2023, dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të kontestuar, sipas pretendimeve nga kërkesa dhe shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës, gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me vendimin e kontestuar të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil-Komisioni për Shqyrtim të Ankesave, me nr. Prot.75/2021, të datës 15.11.2021, është vendosur: Refuzohet si e pa bazuar ankesa e datës 28.09.2021, e paraqitur nga av.Vehbi Halili për korigjimin e datës së lindjes për Znj. Xh.S., nga në, në regjistrin themeltar të lindjes pranë ZGJC P., dhe pranuar nga Sekretaria e Komisionit ARC, me datë 20.10.2021 me nr. 01/168 dhe mbetet në fuqi vendimi i Zyrës së Gjendjes Civile P., me nr. .../. i datës 28.09.2021.

Kundër këtij vendimi pala paditëse ka iniciuar konflikt administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin A.nr.2812/21, i datës 11.07.2023, ka vendosur si në vijim: I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses, Xh.S., me të cilën ka kërkuar nga gjykata, që të anuloj vendimin e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Agjencia e Regjistrimit Civil, me nr.75/2021, të datës 15.11.2021. II Secila palë i bartë shpenzimet e veta administrative.

Në arsyetim të aktgjykimit të saj, gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera thekson se: Gjykata për vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar i'u referua dispozitave të Ligjit për Gjendjen Civile Nr.04/003, respektivisht nenit 29 paragrafi 1, i cili ka përcaktuar: *1. "Kur në Regjistrin qendror të gjendjes civile vërehen gabime materiale ose gjendet rubrikë, që nuk pasqyrojnë përbërësin përkatës, përgjegjësi i Zyrës së gjendjes civile bën korigjimin ose plotësimin, kur: 1.1. përbërësi figuron në librat e akteve, në regjistrat themeltarë të mëparshëm të asaj zyre ose të vendit prej nga ka ardhur, me ndryshim të vendbanimit, për çdo shkak; 1.2. i interesuari paraqet dokumentin bazë nga burimi përgjegjës, sipas ligjit; 1.3. vërtetohet, në të gjitha rastet e tjera, me vendim gjykate.* Gjykata i'u referua edhe Udhëzimit Administrativ 01/2016- Arc, për Korigjimet dhe Plotësimet e Dokumenteve të Arkivuara, ku në nenin 6 paragrafi 2 dhe 3 është përcaktuar, në rastet kur: *"2. Pala e cila ka lindur në institucionin shëndetësor dhe i cili pretendon që i është bërë gabim gjatë regjistrimit të rregullt ose të mëvonshëm në Regjistrin themeltar të lindjes, ofron ndonjërin nga dokumentet që dëshmon se i është bërë gabimi, si në vijim: 2.1 Fletëlëshimin nga institucioni shëndetësor ose dokument i barazvlefshëm; 2.2 Raportin mjekësor nga institucioni shëndetësor, apo librezë shëndetësore, të cilat dëshmojnë për vendin dhe datën e lindjes. 3 Në rastet kur pala ka qenë i regjistruar para 10 qershor të vitit 1999 në Regjistrin themeltar të lindjes dhe mungon ky regjistër, ndërsa pas vitit 1999 nuk gjendet në regjistrat e certifikuar as në regjistrat themeltar të gjendjes civile (origjinal) dhe pretendon se i është bërë gabim gjatë ri-regjistrimit ofron ndonjërin nga dokumentet e lëshuara para 10 qershorit të vitit 1999, si në vijim: .3.1 Certifikatë e*

gjendjes civile; letërnjoftim; pasaportë. Dhe nenit 7 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ 01/2016, me të cilin është përcaktuar: “Korigjimi dhe plotësimi i të dhënave personale të arkivuara, bëhet në bazë të kërkesës që dorëzon parashtruesi, vetëm nëse plotësohen ndonjëri nga kushtet e parapara në nenin 6 të këtij udhëzimi administrativ”.

Gjykata nga provat të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe atë nga: kopja e librit amëz të të lindurve, faqe 56, me numër rendor 17, libër ky që përmban të dhënat bazë nga lindja, e që përbëjnë edhe përbërësit e gjendjes civile të individit, ka vërejtur se paditësja është e lindur me datë, e kjo datë e lindjes për paditësen është e paraqitur edhe në Ekstraktin nga Libri Amëz i të Martuarve me nr.200-2/31 të lëshuar me datë 21.04.1988. Ndërsa nga dëshmia “Raport Martesor i lëshuar nga Komuna e V., me datë 30.09.2021, nga dokumenti “T.....” të lëshuar me datë 06.08.2021 nga Konsulata e Republikës së K., në K., kopja e letërnjoftimit e lëshuar nga SPB V., me datë 26.11.1990, nga vërtetimi i lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në V., e lëshuar me datë 25.08.2021, gjykata vëren se datë e lindjes për paditësen figuron data Mirëpo të gjitha këto dokumente flasin për dokumente të mëvonshme të lëshuar nga autoritet përkatëse, nuk paraqesin dokumente bazë, dhe nuk mund të kuptohet se mbi çfarë bazë paditëses i janë lëshuar dokumentet në fjalë, për faktin se nuk ekziston asnjë dëshmi në Librin amë të të lindurve që paditësja ka lindur me datë, kurse ekzistojnë dëshmi nga Libri amë i të lindurve se paditësja ka lindur me datë, dhe në këtë kuptim këto dokumente nuk paraqesin dëshmi të mjaftueshme për korrigjimin e datëlindjes së paditëses.

Mbi këto arsye kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoi, sepse vlerësoi se nuk është cenuar ligji në dëm të saj. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e përfaqësuesit të paditëses të dhëna në padi dhe në seancë kryesore, sipas të cilit është kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës dhe të korrigjohet data e lindjes dhe të njëjtat i refuzoi si të pabazuar, pasi që nga provat e prezantuar vërehet se vendimet e të paditurës janë marr në përputhje me ligjin dhe se e paditura nuk mund të detyrohet në ndërrimin datës së lindjes pasi që nuk ka vend për korrigjim të të dhënave të arkivuar, duke qenë se të dhënat e paditësit që evidentohen në Regjistrin e Lindjes, që është burim i identiteti të saj nuk flasin për gabime për të cilat është i nevojshëm korrigjimi, Përkatësisht nga gjykata u vërtetua se nga paditësja nuk janë plotësuar kushtet siç janë përcaktuar në nenin 29 të Ligjit 04/L-003 dhe nenin 6 të Udhëzimit 01/2016, dhe në këtë mënyrë nuk gjejnë vend pretendimet e përfaqësuesit të paditëses për ndryshimin e të dhënave të lindjes bazuar në nenin 38 dhe 39 të ligjit 04/L-003. Prandaj, gjykata e shkallës së parë vlerësoi se në këtë çështje administrative nga e paditura drejtë është vërtetuar gjendja faktike, drejtë janë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe të ligjit material, me rastin e marrjes së vendimit të kontestuar dhe mbi këto arsye thëniet e paditëses në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga e paditura dhe në kuptim të nenit 43, 46.2 lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe 194, 195.1 par. d) dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga

gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë theksohet se: Edhe pse nuk ka pasur pretendime ankimore në drejtim të shkeljeve të procedurës, megjithatë kolegji i apelit vëren se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPK-së, dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së. Sa i përket pretendimit ankimor për vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike kolegji i apelit i vlerëson këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditëses janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Andaj, duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, ankesën e paditëses e refuzoi si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar e vërtetoi si të drejtë dhe të ligjshëm, me që paditësja nuk kishte paraqitur asnjë provë me ankesë për ti argumentuar pretendimet e saj, ndërsa ato ekzistuese në lëndë nuk ishin me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike administrative.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes pas shqyrtimit të kërkesës së paditëses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të provave tjera në shkresat e lëndës, gjen se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur drejtë, me refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses nga gjykata e shkallës së parë, dhe refuzimin e ankesës dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nga gjykata e shkallës së dytë të kontestuar me kërkesë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, si të drejtë dhe ligjor në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, nga se aktgjykimi i kontestuar me kërkesë i Gjykatës së Apelit por as i shkallës së parë, nuk janë të përfshirë me aplikimin e gabuar të drejtës materiale, ashtu si pretendon paditësja në kërkesën e saj. Nga aktet në lëndë shihet se paditësja, nuk ka arritur të dëshmojë para organeve të administratës dhe as në shqyrtim gjyqësor, me prova konkrete të listuara si në nenin 6 paragraf 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ 01/2016-Arc, për Korigjimet dhe Plotësimet e Dokumenteve të Arkivuara, në bazë të së cilave e paditura do të kishte të drejtë të bëjë korigjimin e datëlindjes.

Nga të dhënat respektive në regjistrin civil përkatësisht, të dhënat nga Libri Themeltar i të Lindurve, faqe 56, nr. rendor 17, datë e lindjes së paditëses figuron data, Paditësja në këtë libër rezulton të jetë regjistruar me datë, ndërsa në rubrikën shënimet dhe regjistrimet pasuese, figuron se e njëjta ka lidhur kurorë me I. S., me datë, ndërsa të gjitha provat e tjera të parashtruara nga paditësja i referohen datave të mëvonshme të lëshimit të tyre, andaj e njëjta nuk mund të ndryshohet pa dëshminë, respektivisht dokumentin bazë mbi korigjimin.

Pretendimet e paditëses të theksuar si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5, të Ligjit

kundër Diskriminimit si dhe dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe zbatimin e Ligjit më të favorshëm të ish jugosllavisë, SFRJ, br.52/56; 10/65 ..., kolegji i Gjykatës Supreme i refuzoi si të pabazuara dhe të pa qëndrueshme, të njëjta nuk janë specifikuar se si dhe pse janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me këto nene, apo se si është diskriminuar, andaj vetëm referimi nuk është i mjaftueshëm për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje të Kushtetutës apo akteve dhe instrumenteve ndërkombëtare drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës. Nga shkresat e lëndës shihet se, paditëses nga gjykatat e instancës më të ulët i është dhënë mundësia e qasjes në procedurë, qasjes në gjykatë, deklaramit dhe shprehjes së pretendimeve dhe përgjigjes ndaj deklaramive të palës kundërshtare, të paraqitjes së provave dhe fakteve, parashtrimi i mjeteve juridike dhe ushtrimi i të gjitha të drejtat të tjera të garantuara me Kushtetutë dhe me ligjet në fuqi, ndërsa paditësja ka dështuar të dëshmoj se të njëjtës i është mohuar apo shkelur ndonjë nga të drejtat e saj të përcaktuara ligjore qoftë gjatë procedurës administrative pranë organit të administratës apo gjatë konfliktit administrativ para gjykatave të rregullta.

Ndonëse paditësja nuk ka përmendur si bazë për atakimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë shkeljen e dispozitave të procedurës, përgjatë elaborimit të kërkesës, gjykata ka vërejtur se e njëjta ka theksuar shkeljen e dispozitave nga neni 9, 13, 15 par.1, pika 1.3, 34 par.1 pika 1.3, të LKA-së, si dhe nenit 160 dhe 175, të LPK-së. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktvendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm dhe i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës. Në arsyetimin e aktvendimit të kontestuar janë dhënë mjaft arsye lidhur me faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, gjykata vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditëses

Gjykata nuk i shqyrtoi pretendimet e tjera të parashtrueses të kërkesës, lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pasur parasysh se, sipas dispozitës së nenit 24 paragraf 2 të LKA-së, përcaktohet se: *“Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes”*.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë.

Nga theksimet si më lartë, dhe në pajtim me nenin 54 paragrafi 1, i Ligjit për Konfliktet Administrative u vendos si së dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.149/2024, datë 30 Janar 2025

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani